



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenet 4,7 dhe 8 paragrafi 5 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme nr. 03/L-139 dhe me ndryshimet dhe plotësimet me Ligjin nr. 03/L-205 dhe nenit 16 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, sipas kërkesës nr.02-463/06-0014295/19 të datës 19.02.2019 të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit për iniciimin e procedurës së shpronësimit, merr:

VENDIM PËR PRANIMIN E KËRKESËS PËR SHQYRTIM TË MËTEJMË

Neni 1

Miratohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës së Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit për shpronësimin e parcelave në Zonën Kadastrale Podujevë, sipas Listës me përshkrim detaj të paluajtshmërive në shtojcë të këtij Vendimi.

Neni 2

Kërkesa për shpronësim do të shqyrtohet në procedurë të mëtejme me qëllim të arritjes së qëllimit të ligjshëm publik për realizimin e projektit *"Asfaltimi i rrugës te Xhamia në Podujevë me infrastrukturë përcjellëse, ndriçim publik, kanalizim fekal, kanalizim atmosferik, rrjet të ndriçimit, ujësjellësit, sinjalizim horizontal dhe vertikal, ura mbi lumin llap(afër kompleksit banesor Malësia), sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës nr. 01-016/01-0093084/18, i datës 30.11.2018.*

Neni 3

Vlerësimi i pronave sipas nenit 1 të këtij vendimi caktohet nga Zyra për Vlerësimin e pronës së paluajtshëm në kuadër të Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, Drejtoria e Buxhetit dhe Financave si dhe Drejtoritë dhe shërbimet tjera varësisht nevojave të paraqitura në funksion të realizimit të këtij projekti.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi pas publikimit në ueb faqen e Komunës dhe Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Vendimi u dërgohet:

- Të gjitha Drejtorive të Komunës
- Qendrës së Shërbimit për Qytetarë
- Në dosje

Nr.02-464/01-0018119/19

Podujevë, datë: 28 shkurt 2019



**Kryetari i Komunës
Agim Veliu**



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

NJOFTIM

Bazuar në nenin 8 paragrafët 7.3 dhe 8.2 të Ligjit nr. 03 / L-139, për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28.10.2010 dhe Vendimin e Kryetarit të Komunës nr. prot.02-464/01-0018119/19 të datës 28 shkurt 2019, njoftohen të gjithë subjektet e listuara në Vendimin e bashkangjitur këtij njoftimi se:

1. Për arritjen e qëllimit të ligjshëm publik për realizimin e projektit” ***”Asfaltimi i rrugës te Xhamia në Podujevë me infrastrukturë përcjellëse, ndriçim publik, kanalizim fekal, kanalizim atmosferik, rrjet të ndriçimit, ujësjellësit, sinjalizim horizontal dhe vertikal, ura mbi lumin llap(afër kompleksit banesor Malësia)***, Kryetari i Komunës së Podujevës ,duke u bazuar në nenin 4 paragrafi 2 të Ligjit nr. 03 / L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28.10.2010, me Vendimin nr.prot.02-464/01-0018119/19 të datës 28 shkurt 2019 ka miratuar e kërkesën nr. prot. 02-463/06-0014295/19 të datës 19 shkurt 2019 të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, për shqyrtimin e mëtejme për shpronësimin e pronave të paluajtshme, për realizimin e projektit të cekur.

2. Kryetari i Komunës do të marrë një Vendim Preliminar brenda periudhës prej 30 ditësh pas përmbushjes së kushteve të parapara nga neni 9 të Ligjit nr. 03 / L-139, për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28.10.2010, lidhur me organizmin e dëgjimeve publike.

3. Çdo person i interesuar ka të drejtë të paraqesë komentet e tij me shkrim lidhur me shpronësimin e propozuar në Organin Shpronësues, brenda 10 ditëve kalendarike, pas shpalljes së vendimit për shqyrtimin e mëtejme të kërkesës për shpronësim, në Gazetën Zyrtare të e Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

4. Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë do të mbajë një dëgjim publik lidhur me shpronësimin e kërkuar për realizimin e projektit në fjalë.

5. Të gjithë personat të cilët janë zyrtarë publik të Komunës në të cilën mbahet dëgjimi publik apo pronarë ose zotërues të interesit në pronën e cila gjendet në këtë pjesë ose

avokat apo përfaqësues të ligjshëm të këtyre personave, kanë të drejtë të marrin pjesë në dëgjimin publik të cilët do të kenë mundësinë për t'i shprehur mendimet gojarisht lidhur me shpronësimin e kërkuar në përputhje me paragrafët 2 deri 4 të nenit 9 të Ligjit nr. 03 / L-139, për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28.10.2010”.

6. Çdo person i cili dëshiron të marrë pjesë ose të shprehë mendimet e tij/saj në dëgjimin publik duhet të sjellë me vete prova të arsyeshme (dokumente) të cilat dëshmojnë se ai/ajo është në fakt zyrtar publik, pronar ose zotërues i interesit ose avokat ose përfaqësues i ligjshëm i atij zyrtari publik, Pronari ose Zotëruesi të Interesit.

7. Dëgjimi publik lidhur me shpronësimin e kërkuar, të të drejtave pronësore apo të drejtave të tjera në pronat e paluajtshme, **do të mbahet më 25 mars 2019, në ora 10:00, salla e mbledhjeve të Kuvendit në objektin kryesor të Komunës.**

8. Pas përmbylljes së procedurës së shpronësimit të iniciuar sipas kërkesës, asnjë kompensim nuk do të paguhet për shpenzimet ose vlerën e çfarëdo përmirësimi të bërë në pronë, objekteve të ndërtuara ose zgjeruara në pronë, ose pemëve, bimëve të mbjella në pronë pas datës së përbushjes së dispozitave përkatëse të paragrafit 8 të nenit 8 të “Ligjit nr. 03 / L-139, për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28.10.2010 . Çdo person i cili pretendon se ka një interes pronësor ose interes tjetër të ligjshëm në pronën përkatëse këshillohet ta shqyrtojë Ligjin nr. 03 / L-139, për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28.10.2010, dhe të kërkojë ndihmë profesionale juridike për kuptimin e të drejtave të tyre sipas ligjit.



9. Çdo Person i cili nuk është emëruar në njoftim dhe i cili pretendon se zotëron një interes pronësor ose interes tjetër të ligjshëm në cilëndo parcelë të pronës së paluajtshme të përshkruar në njoftim menjëherë duhet të dërgojë në Organin Shpronësues një përshkrim të pretendimit të tij/saj, bazën juridike të atij pretendimi si dhe kopjet e certifikuara të çfarëdo dokumenteve që ndërlidhen me atë pretendim.

**Kryetari i Komunës**
Agim Veliu

| Nr. | Emri mbiemri i pronarit ose zotëruesit | Nr. i ngastrës | Lloji i shfrytëzimit | Zona Kadastrale | Sipërfaqja e përgjithshme M ² | Sipërfaqja e pjesës së ngastrës për shpronësim M ² |
|-----|--|----------------|-------------------------------|-----------------|--|---|
| 1 | -Beqir (Maliq) Hajdari -Enver (Maliq) Hajdari -Salih (Maliq) Hajdari | 01442-3 | Tokë ndërtimore | Podujevë | 402 | 103 |
| 2 | -Beqir (Maliq) Hajdari -Emver (Maliq) Hajdari -Salih (Maliq) Hajdari | 01442-2 | Tokë ndërtimore | Podujevë | 250 | |
| 3 | -Çajup (Ruzhdi) Hajdari | 01442-1 | Tokë ndërtimore/ pemishtë | Podujevë | 586 | |
| 4 | -Ganimete (Adem) Bejta | 01424-2 | Tokë ndërtimore/ bujqësore | Podujevë | 599 | 278 |
| 5 | Bejtush (Jakup) Bejta, (Hipotekë Raiffaisien Bank) | 01424-1 | Tokë ndërtimore/ bujqësore | Podujevë | 619 | |
| 6 | -Bedri (Halil) Kadriu -Halil (Kadri) Kadriu -Fazli (Halil) Kadriu | 01406-4 | Bujqësore | Podujevë | 1642 | 245 |
| 7 | Fazli (Halil) Kadriu | 01406-3 | Bujqësore | Podujevë | 4434 | |
| 8 | Kadrush (Halil) Kadriu | 01406-2 | Bujqësore | Podujevë | 4204 | |
| 9 | Bedri (Halil) Kadriu | 01406-1 | Bujqësore | Podujevë | 5495 | |
| 10 | Fazli (Halil) Kadriu | 01405-2 | Bujqësore | Podujevë | 631 | 1207 |
| 11 | Kadrush (Halil) Kadriu | 01405-1 | Bujqësore | Podujevë | 961 | |
| 12 | Mithat Ejup Mehmeti | 00431-4 | Bujqësore | Podujevë | 308 | 208 |
| 13 | -Rifat (Rexhep) Blaku -Murat (Rexhep) Blaku -Bajram (Latif) Blaku -Ali (Imer) Blaku -Fahrie (Imer) Blaku -Ismet (Imer) Blaku -Agon (Haki) Blaku -Jeton (Haki) Blaku -Tefik (Muharrem) Blaku -Ragip (Muharrem) Blaku | 00431-3 | Bujqësore | Podujevë | 207 | |
| 14 | -Ramadan (Gani) Salihu -Avdyl (Rushit) Salihu -Bashkim(Nazmi) Mulolli | 00501-5 | Rrugë | Podujevë | 15 | 2 |
| 15 | Pronë Shoqërore – Ujërat | 02852-0 | Lum | Podujevë | 153912 | 1397 |
| 16 | Pronë Shoqërore – Rrugë publike | 02847-0 | Rrugë e paketekorizuar | Podujevë | 6775 | 36 |

| | | | | | | |
|----|--|---|------------------------|----------|-------------------------------------|------|
| 17 | Pronë Shoqërore – Rrugë publike | 01440-0 | Rrugë e paketekorizuar | Podujevë | 724 | 133 |
| 18 | Raif (Isuf) Bekteshi | 01441-0 | Oborr/kullor/s/shtëpi | Podujevë | 792 | 88 |
| 19 | -Bedri (Halil) Kadriu -Halil (Kadri) Kadriu -Fazli (Halil) Kadriu | 01404-0 | Pemisht/oborr/shtëpi | Podujevë | 3364 | 6 |
| 20 | Fazli (Halil) Kadriu | 1403-0 | Kulloso | Podujevë | 758 | 551 |
| 21 | -Bislir (Hamdi) Blaku -Ruzhdi (Ramadan) Blaku -Latif (Latif) Balku -Shefki (Shemsi) Blaku -Ajshe (Zeqir) Blakqori -Fatime (Zeqir) Blakqori -Avdyl (Zeqir) Blaku -Agim (Zeqir) Blaku -Qazim (Zeqir) Blaku | 01401-0 | Kulloso | Podujevë | 189 | 189 |
| 22 | -Muhamed (Halim) Aliu -Besime (Rrahim) Aliu | 00431-1 | Kullosat | Podujevë | 176 | 107 |
| 23 | Pronë Shoqërore – Ujërat | 00656-0 | Lum | Podujevë | 17393 | 983 |
| 24 | Pronë Shoqërore – Rrugë Publike | 00429-0 | Rrugë | Podujevë | 855 | 39 |
| 25 | Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës – Këshilli i Bashkësisë Islame Podujevë | 00434-0 | Kulloso | Podujevë | 1643 | 24 |
| 26 | Ragip (Halit) Kika | 00436-8 | Bujqësore - Arat | Podujevë | 1060 | 39 |
| 27 | Ragip (Halit) Kika | 00436-4 | Bujqësore - Arat | Podujevë | 710 | 13 |
| 28 | Pronë Shoqërore – Rrugë Publike | 00426-0 | Rrugë e pakategorizuar | Podujevë | 785 | 30 |
| 29 | -Jetullah (Ibrahim) Hajdari -Jetullah (Ibrahim) Hajdari -Hajdar (Ibrahim) Hajdari -Ismail (Ibrahim) Hajdari -Rexhep (Ibrahim) Hajdari | 02997-1 02997-7 02997-2 02997-3 02997-4 | Bujqësore - Arat | Podujevë | 2498 939 2496 2557 3303 | 1396 |

Drejtori i Drejtorisë së
Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë
Abaz Llualiu

Drejtori i Drejtorisë së
Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes
së Mjedisit
Hamdi Jaha

